



Ulpiana Neighborhood | Zija Shamsiu Str. | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

Kodi i IPKO-së LEG. 08 | **KODI I PAJTUESHMËRISË ME NORMAT BIZNESORE PËR KONTRATORËT e IPKO-së**

Dokumenti/ Titulli	Kodi i IPKO-së. LEG. 08 Kodi i Kontraktorëve për Normat Biznesore
Versioni	v. 1.3
Data e hyrjes në fuqi e propozimit të miratuar	27.03.2026
Data e zbatueshmërisë së drafteve të mëparshme	01.04.2023
Data e zbatueshmërisë së këtij versioni	08.04.2026
Autori kryesor	Telekom Slovenije Finalizuar nga: Klestë Hamzaj Edmond Vllasaliu
Përgjegjës	Departamenti për Çështje Ligjore dhe të Rregullatorit

Historia e Rishikimit:

Versioni	Detajet	Data	Versioni nga:
1.0	Kodi i Kontraktorëve për Normat Biznesore	25.08.2020	Departamenti për Çështje Ligjore dhe të Rregullatorit
1.1	Rishikimi i Kodit të Kontraktorëve për Normat Biznesore	15.10.2021	Departamenti për Çështje Ligjore dhe të Rregullatorit
1.2	Rishikimi i Kodit të Kontraktorëve për Normat Biznesore	28.02.2023	Departamenti për Çështje Ligjore dhe të Rregullatorit

1.3	Rishikimi i Kodit të Kontraktorëve për Normat Biznesore	08.04.2026	Pajtueshmëria
-----	---	------------	---------------

1. PAJTUESHMËRIA ME NORMA BIZNESORE

Neni 1

1. IPKO Telecommunications LLC (në tekstin e mëtejshëm: IPKO) përpiqet të arrijë standardet më të larta etike dhe afariste.
2. Kodi i Pajtueshmërisë me normat biznesore për Kontraktorët e IPKO-së (në tekstin e mëtejshëm: Kodi) përcakton parimet dhe standardet kryesore për furnizuesit e mallrave, ofruesit e shërbimeve dhe partnerët e tjerë afarist (në vijim të referuar bashkërisht si: Kontraktorët) të IPKO's në përputhje me rregulloret e brendshme të IPKO-së.
3. Gjatë ekzistimit të marrëdhënies biznesore, Kontraktori merr përsipër të veprojë në përputhje me të gjitha rregulloret a zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Për më tepër, Kontraktori do të përpiqet të respektoj standardet më të larta etike dhe afariste në përputhje me dispozitat dhe udhëzimet e këtij Kodi. Varësisht nga fushëveprimi dhe lëmia e biznesit, Kontraktori tutje merr përsipër krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të përshtatshëm për monitorimin e pajtueshmërisë afariste.
4. Kontraktori më tutje garanton që furnizuesit dhe kontraktorët e tij do t'i përmbahen zotimeve dhe përpjekjeve të njëjta të përcaktuara nga paragrafi i mësipërm (përgjegjësia për të gjithë zinxhirin e furnizimit).

2. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT PËR PUNONJËSIT

Neni 2

1. Kontraktori merr përsipër të mbrojë të drejtat themelore të njeriut për punonjësit e tij, dhe të veproj në pajtueshmëri me ligjin e zbatueshëm të punës, dhe veçanërisht:
 - Të sigurojë për punonjësit një mjedis pune pa kurrfarë forme të diskriminimit ose ngacmimit për shkak të gjinisë, ngjyrës, moshës, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare e politike ose bindjeve të tjera, përkatësisë kombëtare dhe shoqërore, gjendjes financiare, orientimit seksual ose prejardhjes tjetër personale;
 - Të respektoj dinjitetin personal, privatësinë dhe të drejtat e tjera të individit;
 - Të veproj në pajtueshmëri me ndalimin e punës së fëmijëve ose punës së detyruar. Kontraktori merr përsipër që të mos punësojë persona nën moshën 15 vjeçe.
 - Të sigurojë për punonjësit kompensim të drejtë, në pajtim me dispozitat ligjore lidhur me pagën minimale dhe përfitimet sociale në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë pagesën e detyrimeve të papaguara ndaj kontraktorëve brenda afatit ligjor ose kontraktual;
 - Të zbatojë dispozitat ligjore lidhur me llogaritjen dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të punonjësve dhe pagesave të tjera tatimore;
 - Të respektojë kufizimet në lidhje me kohëzgjatjen e kohës së punës, duke përfshirë edhe punën jashtë orarit, të zbatueshme në vendin përkatës;

- Të njoh të drejtën e punonjësit për shoqërim të lirë dhe negociata kolektive.

3. SHËNDETI DHE SIGURIA PROFESIONALE

Neni 3

1. Kontraktori është përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë profesionale të punonjësve të tij dhe duhet të krijoj procese përkatëse organizative për të siguruar pajtueshmërinë në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë. Kontraktori duhet t'i identifikoj dhe vlerësoj rreziqet e sigurisë, dhe të miratojë masat përkatëse për parandalimin e tyre. Për më tepër, Kontraktori i informon punonjësit lidhur me çfarëdo rreziku të sigurisë dhe u siguron atyre trajnime përkatëse lidhur me sjelljen korrekte dhe të sigurt dhe për masat përkatëse të sigurisë.

4. MJEDISI

Neni 4

1. Kontraktori do të veproj në përputhje me ligjin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me kujdesin mjedisor. Në përputhje me këtë, Kontraktori do të kërkojë të zvogëlojë ndotjen dhe të përpiqet për përmirësim të vazhdueshëm të mjedisit. Proceset e prodhimit duhet të jenë të dizajnuara ashtu që të parandalojnë ndikimin negativ mjedisor dhe që të ruajnë burimet natyrore në masën maksimale të mundshme.

5. PARIMET E MARRËDHËNIES AFARISTE

Pajtueshmëria me ligjin për konkurrencën

Neni 5

1. Kontraktori do të veprojë në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së konkurrencës si dhe me praktikën e mira që rregullojnë shpërdorimin e pozitës dominuese, si dhe gjithashtu edhe me të gjitha sjelljet e tjera që kanë për synim kufizimin e konkurrencës. Kontraktori nuk do të angazhohet në asnjë marrëveshje për caktimin e çmimeve, ndarjen e tregut, konsumatorëve ose kanaleve të blerjes, e as nuk do të koordinojë ofertat e tij me konkurrentët e tij.

Konflikti i interesit

Neni 6

1. Kontraktori do të shmangë dhe korrigjojë situatat që përbëjnë një konflikt interesi, të cilat mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet afariste. Në rast të identifikimit të konfliktit të interesit nga Kontraktori, i njëjti duhet të njoftoj Kompaninë.

Korrupsioni

Neni 7

1. Kontraktori do të veprojë në përputhje me standardet më të larta të integritetit në të gjitha ndërveprimet e tij të biznesit. Ai do të veprojë në përputhje me legjisllacionin e zbatueshëm kundër korrupsionit dhe të refuzoj të gjitha format e ryshfetit apo format e tjera të korrupsionit.

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit

Neni 8

1. Kontraktori do të veprojë në përputhje me ligjin në fuqi që rregullon parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe do të miratoj masat përkatëse për të parandaluar pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.

Pajtueshmëria me rregulloret tatimore

Neni 9

1. Kontraktori gjatë gjithë kohës do të veprojë në përputhje me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi që kanë të bëjnë me taksat.

Sekreti tregtar, mbrojtja e të dhënave dhe pronësia intelektuale

Neni 10

- Kontraktori do të ruajë konfidencialitetin e të gjitha sekreteve tregtare dhe të trajtojë informatat dhe të dhënat konfidenciale në përputhje me fushëveprimin e kërkuar dhe të lejuar në një mënyrë, që parandalon zbulimin e informatave dhe të dhënave të tilla tek palët e treta.
- Kontraktori gjithmonë do të veprojë në përputhje me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe të pronësisë intelektuale.

6. SHKELJET E KODIT TË BIZNESIT

Neni 11

1. Pajtueshmëria me dispozitat e Kodit është thelbësore për marrëdhënien afariste ndërmjet IPKO's dhe Kontraktorit. IPKO ruan të drejtën për të verifikuar pajtueshmërinë e sjelljes së Kontraktorit me Kodin. Në rast se IPKO konstaton se Kontraktori e shkel Kodin, ajo mundet që, pavarësisht nga dispozitat e tjera kontraktuale midis palëve, të anulojë bashkëpunimin kontraktual pa ofruar njoftim.
2. Ky kod do të publikohet në faqen e intranetit dhe të internetit të IPKO-së, pas aprovimit.

András Páli
CEO